

Njoftim për përqendrim me të cilin Daimler Trak AG, Gjermani, Elektrifajd Pauer Holdko LLC dhe PAKKAR Inc., Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të fitojnë kontroll të përbashkët të një kompanie që do të themelohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe do të jetë aktive në prodhimin e litium-jonit, qelizave të baterisë për përdorim parësor në klasa specifike të automjeteve komerciale dhe aplikacioneve për ruajtjen e energjisë stacionare

(lënda nr. 08-166 /2023)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 17.11.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga Daimler Trak AG me seli të regjistruar në Fazanenveg 10, 70771 Lajnfelden-Ehterdingen, Gjermani, Elektrifajd Pauer Holdko LLC me seli të regjistruar në 500 Xhekson Street, Kolumbus, Indianë, 47201, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe PAKKAR Inc me seli të regjistruar në 777 106th Avenju N.E. Bellevju, Uashington, 98004, Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbi një ndërmarrje që do të themelohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe do të jetë aktive në prodhimin e litium-jonit, qelizave të baterisë për përdorim parësor në klasa specifike të automjeteve komerciale dhe aplikacioneve për ruajtjen e energjisë stacionare.

- **Daimler Trak AG** është një shoqëri e cila kuoton në bursë me seli në Lajnfelden-Ehterdingen, Gjermani dhe është një nga prodhuesit më të mëdhenj të automjeteve komerciale në botë, që ofron kamionë të lehtë, të mesëm dhe të rëndë, autobusë të qytetit dhe ndërqytetës, dhe autobusë transporti, si dhe shërbime të zgjedhura financiare.

Daimler Trak nuk ka një shoqëri të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, por gjeneron të ardhura në tregun maqedonas duke shitur automjete përmes distributorëve të pavarur.

Elektrifajd Pauer Holdko LLC është blerësi i drejtpërdrejtë në transaksionin e propozuar dhe një shoqëri e varur në pronësi të plotë të Kamins.

-**Kamins** është shoqëri udhëheqëse e Elektrifajd Pauer dhe një shoqëri që kouton në bursë, me seli në Kolumbus, Indianë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës , që projektton, prodhon, shpërndan dhe shërben një portofol zgjidhjesh të energjisë, duke përfshirë naftën, gazin natyror, motorët elektrikë dhe hibridë dhe komponentët e motorit, duke përfshirë filtrimin, trajtimin e mëtejshëm, turbochargers, sistemet e karburantit, sistemet e kontrollit, sistemet e trajtimit të ajrit, transmetimet e automatizuara, boshtet, linjat e lëvizjes, frenat, sistemet e pezullimit, sistemet e prodhimit të energjisë elektrike, bateritë, sistemet e energjisë elektrike të elektrizuar,, prodhimi i hidrogjenit dhe prodhimi i qelizave të karburantit.

Kamins nuk ka shoqëri të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, por pothuajse të gjitha të ardhurat e saj i nxjerr nga tregu maqedonas përmes një shoqëria të varur në pronësi të plotë indirekte, Kamins Belgia NV, Belgjikë, që furnizon motorë automobilistikë për automjete të lehta komerciale (p.sh. autobusë) të prodhuar në Maqedoninë e Veriut.

- **PAKKAR Inc** me seli në Bellvju, Uashington, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është aktive në projektimin, prodhimin dhe mbështetjen e përdoruesve të kamionëve të lehtë, të mesëm dhe të rëndë me cilësi të lartë nën etiketat Kenworth, Peterbilt dhe DAF. PAKKAR projektton dhe prodhon fabrika të avancuara, ofron shërbime financiare dhe teknologji informacioni dhe shpërndan pjesë kamionësh që lidhen me biznesin e saj kryesor.

PAKKAR nuk ka një shoqëri të varur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, por gjeneron të ardhura në tregun maqedonas përmes shitjes së kamionëve dhe pjesëve përmes një distributori.

Në momentin e dorëzimit të këtij Njoftimi, **Shoqëria e synuar** ende nuk është themeluar. Megjithatë, shoqëria e Synuar synon të prodhojë qeliza të baterive Li-ion për përdorim parësor në klasa të caktuara të automjeteve komerciale dhe aplikacioneve industriale. Shoqëria e synuar do të zhvillojë dhe prodhojë një bateri litium-ferro-fosfat („**LFF**“) nga familja e teknologjisë për kamionët komercialë me bateri elektrike.

Tregu relevant i mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet **si treg për furnizimin e qelizave dhe moduleve (duke mos përfshirë sistemet e baterive) për bateritë Li-jon.**

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

21.11.2023

Shkup